

Depozita progresive 5 Vjeçare

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr "Ismail Qemali", Nr. 27,
Kutia postare 8319
1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe rreziqet e "Depozita progresive 5 Vjeçare"

Karakteristikat e "Depozita progresive 5 Vjeçare"

Depozita " Depozita progresive 5 Vjeçare" është një lloj alternative depozite me afat që i ofrohet klientëve individ. Kjo depozitë mund të hapet vetëm në LEK. Nuk ka asnjë limit për shumën që do të investohet. Fondet për këtë depozitë kanalizohen nëpërmjet llogarisë rrjedhëse të klientit. Në datën e maturimit depozita nuk është e rinovueshme, dhe në këtë datë principali dhe interesi (minus tatimin në burim) do të kreditohen në llogarinë rrjedhëse të klientit.

Interesi i depozitës është me bazë vjetore dhe likuidimi i tij bëhet po në baza vjetore.

Klienti mund ta thyej depozitën në çdo kohë para maturitetit, por nëse depozita thyhet penaliteti që ai duhet të paguajë është si më poshtë vijon:

1. Thyerja e depozitës nuk lejohet gjatë vitit të parë. Në raste përjashtimore, depozituesi do të humbasë interesin e akumuluar të vitit aktual dhe interesat që do të përfitohen për vitet e mbetura deri në maturim;
2. Nëse depozituesi do të kërkojë thyerjen e depozitës përgjatë vitit të 2të-5të, atëherë depozituesi do të humbasë interesin për vitin kur kryhet thyerja e depozitës, dhe interesin që do të përfitohet për vitet e mbetura deri në maturim.

Tregu i synuar

Tregu i synuar për Depozitën "Depozita progresive 5 Vjeçare" janë të gjithë klientët individë që kërkojnë një investim afatgjatë dhe në të njëjtën kohë likuidim interesi me bazë vjetore, si dhe mundësinë e zgjedhjes mes kalimit të interesit në llogarinë rrjedhëse ose kapitalizimit të tij në depozitë me bazë vjetore.

Dokumentet e nevojshme

Pasaportë/ Kartë Identiteti
Kërkesa për Depozitën me Afat 5 vjeçar
Kontrata e Depozitës

Shërbime suplementare

Për hapjen e depozitës është e nevojshme një llogari rrjedhëse

Rreziqet e "Depozita progresive 5 Vjeçare"

1.Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100 përqind, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

2.Llogaria rrjedhëse që lidhet me depozitën me afat është pa komision vetëm nëse përdoret ekskluzivisht për transaksionet e depozitës me afat dhe nuk lidhet me ndonjë produkt tjetër, në të kundërt do të aplikohet komisioni i mirëmbajtjes mujore sipas Kushteve të Punës në fuqi.

3. Në rastin e depozitë në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e normave të interesit.

Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit

Normat e interesit LEK (%)

Depozita " Depozita progresive 5 Vjeçare "

	Y1	Y2	Y3	Y4	Y5
LEK ≤3,999,999	0.90	1.20	2.10	3.40	3.70
LEK ≥4,000,000	1.00	1.30	2.40	3.40	4.00

Komision mirëmbajtje

Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë në LEK* Falas

**Për referim në seksionin "Rreziqete Depozita progresive 5 Vjeçare"*

Tatim i mbajtur ne burim

Tatimi ne burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm ne momentin e përfitimt te interesit 15% e interesit të përfutuar

Kosto të tjera të lidhura me depozitën

Lëvizjet e aktivitetit të depozitës*	100 LEK nxjerrje llogarie për muajin aktual; 200 LEK nxjerrje llogarie për vitin aktual; 500 LEK nxjerrje llogarie për vite të mëparshme * Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e lëvizjes së llogarisë/ve.
Rritja e shumës së depozitës	Jo e aplikueshme
Ulja e shumës së depozitës	Jo e aplikueshme
Lëshimi i konfirmimit bankar	1,000 LEK (opsionale sipas kërkesës së klientit)

Shëmbull ilustrativ për likuidimin e interesit

Shuma	500,000.00 LEK
Interesi bruto	56,500.00 LEK
Taksa	8,475.00 LEK
Interesi neto	48,025.00 LEK
Periodiciteti i interesit dhe pagesës së taksave	Ne fund te periudhës respektive
Data e likuidimit te interesit	Ne fund te periudhës respektive

Terheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Terheqja nga kontrata

Në rast të thyerjes së depozitës, lejohet vetëm likuidimet e plota të depozitës. Likuidimet e pjesshme nuk janë të lejuara. Klienti mund ta thyej depozitën në çdo kohë para maturitetit; por nëse depozita thyhet, penaliteti që ai duhet të paguajë është si më poshtë vijon:

1. Thyerja e depozitës nuk lejohet gjatë vitit të parë. Në raste përjashtimore, depozituesi do të humbasë interesin e akumuluar të vitit aktual dhe interesat që do të përfitohen për vitet e mbetura deri në maturim;
2. Nëse depozituesi do të kërkojë thyerjen e depozitës përgjatë vitit të 2të-5të, atëherë depozituesi do të humbasë interesin për vitin kur kryhet thyerja e depozitës, dhe interesin që do të përfitohej për vitet e mbetura deri në maturim.

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e depozitës, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e llogarisë nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "*Kutinë e ankesave & sugjerimeve*" që ndodhet në degë (*Ju dëgjojmë 100%*);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të e-mail-it: *complain@intesasanpaolobank.al*
- Në Qendrën e Kontaktit: *08006000*

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

Specimen - Specimeni i nënshkrimit, është një dokument i dedikuar ku personat që janë të autorizuar të administrojnë ose të nënshkruajnë për një llogari, do të depozitojnë nënshkrimet e tyre në bankë. Bazuar në nënshkrimin e depozituar, Banka do të lejojë disponimin e llogarisë sipas urdhrave të personave të autorizuar të Klientit.

ASD- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

Tatimi ne burim - është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor të qeverisë. Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna, pagesa interesash ose dividendë.

Penalitet - Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit.